



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 39/08**

**Prishtinë, më 17.12.2008, ora 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Naser Osmani, Kosara Nikolić.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Riza Smaka.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Behxhet Haliti nga MEF-i, përfaqësues të organizatave buxhetore të ftuara, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të organizatave buxhetore që kanë të bëjnë me Projektligjin nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

## 2.1. Shqyrtimi kërkesës buxhetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

**Kryesuesi**, kërkoi sqarime nga përfaqësuesi i Ministrisë lidhur me kërkesën e parashtruar.

**Hamdi Hoti**, theksoi se kërkesa e Ministrisë ka të bëjë me lëvizje të brendshme të mjeteve. Shuma e paraparë për projektin Muzeu i Artit Bashkëkohorë në vlerë prej 300.000€ të ridestinohej në ndërtimin e palestrës sportive në Skenderaj në vlerë prej 150.000€ dhe pjesa tjetër mjeteve prej 150.000€ të ridestinohej për ndërtimin e palestrës sportive në Deçan. Një tjetër kërkesë ka të bëjë për ndarjen e mjeteve shtesë për ndërtimin e sheshit Isa Boletini në Mitrovicë në vlerë prej 100.000€

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se nuk është e kënaqur me mënyrën e trajtimit të kërkesave që vijnë nga Ministrinë, e që në fakt është dashur të trajtoheshin brenda Qeverisë. Të tilla kërkesa Komisioni nuk do të duhej ti shqyrtojë duke ditur edhe faktin se të gjithë ministrat e kanë votuar buxhetin. Kjo formë e punës në mes Komisionit dhe Qeverisë apo Ministrive nuk është e mirë.

**Besa Gaxherri**, përkrahu kërkesën për ndërtimin e sheshit Isa Boletini.

**Haki Shatri**, mbështeti kërkesën e Ministrisë për ndërtimin e sheshit Isa Boletini.

**Agim Krasniqi**, njoftoi se në Janar do të hartohen listat për rregullimin e projekteve andaj çështja e palestrave do të mund të zgjidhet atëherë. Komisioni të vendos për kërkesën për mjetet shtesë.

**Hajdin Abazi**, kërkoi që i njëjti trajtim të bëhet edhe me palestrat tjera sportive (Shtime, Obiliq dhe Malishevë).

**Shkumbin Demaliaj**, u shpreh kundër kësaj kërkesë për shkak të qëllimeve të caktuara të njerëzve për përfitime individuale. Ndërsa lidhur me kërkesën për sheshin e Isa Boletini, theksoi se kjo duhet kryer me vendimin që do të duhej ta nxjerr Qeveria.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me dhjetë vota PËR dhe një KUNDËR (z. Shkumbin Demaliaj) Komisioni nxori këtë:

### P Ë R F U N D I M

- I. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve për ridestinimin e mjeteve nga projekti Muzeu i Artit Bashkëkohorë në vlerë prej 300.000€ në projektet ndërtimi i palestrës sportive në Skenderaj në vlerë prej 150.000€ dhe ndërtimi i palestrës sportive në Deçan në vlerë prej 150.000€
- II. Miratohet kërkesa për ndarjen e mjeteve shtesë nga buxheti i Kosovës në vlerë prej 100.000€ për ndërtimin e sheshit Isa Boletini në Mitrovicë.

## 2.2. Shqyrtimi kërkesës së Komisionit Kosovar të Konkurrencës

**Kryesuesi**, njoftoi se ekziston një kërkesë nga Komisioni i Pavarur i Konkurrencës, buxheti i së cilit nuk është përfshirë nga ana e Qeverisë e as nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Në bazë të ligjit është Komision rregullativ i pavarur dhe i përgjigjet Kuvendit, prandaj duhet menduar që si të inkorporohet në buxhet. Të mbetet pjesë e strukturës së buxhetit të Ministrisë së Tregtisë apo të futet në një linjë të veçantë buxhetore si edhe agjencionet tjera të pavarura.

**Haki Shatri**, duke ditur natyrën e punës së këtij komisioni propozoi që të jetë pjesë e strukturës së buxhetit të Ministrisë së Tregtisë deri në rebalanc të buxhetit. Qëllimi është që deri në ngritjen e kapaciteteve të shfrytëzohj shërbimet operative nga Ministria, por në punë e tij të jetë i pavarur.

**Agim Krasniqi**, njofto se ka pasur takim me përfaqësuesit e këtij komision dhe iu ka propozuar që të mbeten pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe se numri i stafit duhet të jetë më i vogël se sa parashihen me organogramin e tyre.

**Naser Osmani**, theksoi se në bazë të ligjit, punëtorët e këtij agjencioni janë shërbyes civil dhe ligjin e zbaton Ministria. Nëse mbetet të funksionoj në mënyrë të pavarur, obligimet do të jenë më të mëdha. Prandaj u pajtua me propozimin e z. Shatri që deri në rishikim të buxhetit të mbetet pjesë e Ministrisë.

**Kryesuesi**, propozoi që ky komision të krijohet si organizatë e pavarur buxhetore me linjën e veçantë buxhetore dhe të vendoset aty ku janë edhe agjencionet tjera të pavarura. Pasi që ligji e përcakton si komision të pavarur atëherë të miratohet struktura e propozuar e organogramit dhe të funksionoj si agjencion i pavarur.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Komisionit Kosovar të Konkurrencës krijohet si organizatë e pavarur buxhetore. Buxheti i këtij komisioni inkorporohet në tabelat buxhetore me linjë të veçantë buxhetore.

### **2.4. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit**

**Kryesuesi**, njoftoi se kërkesa ka të bëjë me atë që projektet e parapara në bashkëfinancim me komunitat të futen në buxhetin e tyre për të plotësuar regjistrin.

**Agim Krasniqi**, theksoi se kjo çështje është përfshirë brenda rregullatives ligjore. Në Tabelën 2A me një fusnotë parashihet se Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të lidhin Memorandum Mirëkuptimi me Kuvendet Komunale për të rialokuar mjetet kapitale të radhitura në tabelën 3A si Projekte të bashkëfinancuara me Kuvendet Komunale dhe Grandi stimulues në komuna.

### **2.5. Shqyrtimi i pjesës tekstuale të Projektligjit nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**

**Kryesuesi**, theksoi se neni 16 është një çështje e ndjeshme, i cili është diskutuar nga grupet parlamentare, komisionet dhe qëndrimi është që ky nen të riformulohet. Prandaj njoftoi se ka një propozim të ri lidhur me këtë nen. Propozoj që paragrafi 16.1 të mbetet siç është pasi parashih privatizimin e njësive të KEK-ut, për çka edhe ekziston vendimi i Kuvendit për privatizim. Paragrafi 16.3 të fshihet, ndërsa paragrafi 16.2 të riformulohet si vijon: Nëse një ndërmarrje publike ose pjesë e saj që ka përfituar kredi në pajtim me nenin 16.1 nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe që ka vendim për privatizimin, dhënien me koncesion ose formave tjera të partneritetit privat-publik në vitin 2009, atëherë kthimi i kredisë do të jetë pjesë e kontratës në entitetin e ri dhe se realizimi i saj duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë ditë (30) pas nënshkrimit të kontratës.

**Ahmet Shala, Ministër i MEF-it**, theksoi se Qeveria duke u bazuar në vendimin e Kuvendit ka marrë vendim që brenda vitit 2009 të privatizojë KEK-un. Prandaj edhe neni 16 e rregullon këtë çështje. Duke parë propozimet për ndryshimin e këtij neni, kërkoi që neni 16.1 dhe 16.2 të mbeten, ndërsa 16.3 të riformulohet sipas propozimi të kryetarit.

**Haki Shatri**, u pajtua me propozimin e kryetarit që duhet bërë modifikimi i këtij neni, përndryshe nuk do të votohet në Kuvend.

**Besa Gaxherri**, theksoi se gjatë vitit 2009 nuk ka mundësi të kryhet privatizimi. Prandaj edhe rreth propozimit të Qeverisë për privatizim, për tu nënshkruar kontrata për shitjen e njërive të KEK-ut duhet të merret leja paraprakisht nga Kuvendi. Pyeti Ministrin çka nëse nuk realizohet premtimi për nënshkrimin e kontratës.

**Agim Demukaj-FMN**, shprehu mendimin e FMN-së, e cila përkrah vendimin e Qeverisë për privatizimin e KEK-ut, por se konsideron se plani i saj për ta bërë atë brenda vitit 2009 është tepër optimist dhe i parealizueshëm. Qëndrimi i FMN-së është që privatizimi i KEK-ut nuk mund të bëhet të paktën deri në çerekun e parë të vitit 2010. FMN-ja i rekomandon Qeverisë që për përmisimin e performancës së KEK-ut të marrë masa në luftimin e korrupsionit dhe uljen e shpenzimeve të KEK-ut.

**Ahmet Shala, Ministër i MEF-it**, theksoi se me gjithë rezervat që ekzistojnë në këtë çështje, shoqëria kosovare dhe institucionet e saja duhet bërë diçka që rrit prestigjin e Kosovës në botë, si një vend joshës për investime. Në këtë drejtim parashikimet e Qeverisë janë se gjatë vitit 2009, kontrata për shitjen e njërive të KEK-ut mund të bëhet.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me një votë KUNDËR (z. Naser Osmani) Komisioni nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Miratohet propozimi i kryetarit të komisionit z. Gani Koci për ndryshimin e nenit 16 si vijon: Paragrafi 16.1 mbetet, paragrafi 16.3 fshihet, ndërsa paragrafi 16.2 të riformulohet si vijon: Nëse një ndërmarrje publike ose pjesë e saj që ka përfutur kredi në pajtim me nenin 16.1 nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe që ka vendim për privatizimin, dhënien me koncesion ose formave tjera të partneritetit privat-publik në vitin 2009, atëherë kthimi i kredisë do të jetë pjesë e kontratës në entitetin e ri dhe se realizimi i saj duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë ditë (30) pas nënshkrimit të kontratës.

## 8. Të ndryshme

### 2.6. Shqyrtimi i kërkesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për ridestinimin të mjeteve

**Kryesuesi**, njoftoi se kemi një kërkesë nga Kuvendi për ridestinimin të mjeteve. Kërkohet që nga projekti kapital “Vila Gërmija“, të zbritet shuma prej 149,039€ dhe kjo të shpërndahet në këto projekte: për renovimin e sallës nr. 302 shuma prej 11.729€, për renovimin e restaurantin të Kuvendit shuma prej 82.357€, si dhe blerja e paisjeve të IT-së (kompjuterëve) në shumën prej 54.953€

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Miratohet kërkesa e Kuvendit për ridestinimin e mjeteve nga një projekt kapital në projektet tjera siç janë paraparë me kërkesë.

**Besa Gaxherri**, pyeti Ministrin pse shuma për renovimin e ndërtesës “Rilindja” është përfshirë në buxhet kur dihet se një kërkesë të tillë Kuvendi nuk e ka miratuar.

**Ahmet Shala, Ministër i MEF-it**, në përgjigjen e parafolëses, theksoi se Qeveria mundet me vendim të shëndrroj një ndërmarrje shoqërore në ndërmarrje publike, pas pëlqimit të marrë nga bordi i drejtorëve të AKP-së. Një procedurë e tillë është përfillur.

Mbledhja përfundoi në ora 15:55

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**  

---

**Gani KOCI**